



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2018:048642

Datë: 05.03.2021

Numri i dokumentit: 01571496

P.nr.58/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesmarrjen e sekretaresjuridike Shere desku, në çështjen penale kundër të pandehurit: V. (Xh.) B. nga Klina rr. „.....” me çka ka kryer vepër penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafin 1.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/ll.nr.2182/2016, të dt: 17.11.2016, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt.09.02.2021 si dhe shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 24.02.2021 në praninë e Prokurorit të Shtetit: Ersan Qavolli, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit: V. B. dhe të dëmtuarit I. M., pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me dt. 24.02.2021, ndërsa publikisht shpalli aktgjykimin, me dt. 26.02.2021 ndërsa e përpiloi me dt. 05.03.2021 këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: V. B. i atësisë Xh. dhe amësisë M. e vajzërisë G., i lindur me dt. në, ku dhe jeton në rr. „.....” i gjendjes së dobët ekonomike, gjendet në Burgun e Dubravës për vepër penale vjedhje, shqiptar ,shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se:

Me datë 11.09.2016, në orët e mbrëmjes, në rr. „.....” Në me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme merr sende të palujtshme të personit tjetër dhe atë, të dëmtuarit I. M., në atë mënyrë që i pandehuri shkon në vendin e sipër shënuar, i ofrohet shtëpisë së të dëmtuarit, dhe pasi sigurohet e njëjta ishte pa mbikqyrje, duke përdorur forcën, me mjete të përshtatshme ka hapur derën e ballkonit, është futur mbrenda shtëpisë, ku nga një dhomë ka marrë një IPED, ndërsa më pas është larguar nga vendi i ngjarjespa u vërejtur nga askush.

Me çka ka kryer vepër penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me paragrafin 1.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, duke vepruar në kuptim të nenit: 7,8,9,10,17,21,38,40,43,69,70 dhe nenit 327, **327 par.1 lidhur me paragrafin 1.1 të KPRK-së**, si dhe nenit 359,360,361,365,366,450 të KPPRK, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

I.Të pandehurin V. B. , me dënim Burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili denim nuk do të ekzekutohen në afat prej 3 (tri) vite, në qoftë se i pandehuri, gjatë kësaj kohe te verifikimit nuk do të kryej vepër të re penale.Dhe:

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që:

I.Gjykata i përcakton dënimin me gjobë në shumën prej **400 (katërqind) Euro**, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 uro të gjobës.

II.Lirohet i pandehuri nga shpenzimet procedurale, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike.

III.UDHEZOHET: Pala e dëmtuar I. M. nga, që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregulltë civil.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore Pejë-Dega në Klinë, Prokuroria Themelore në Pejë,Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngritur Aktakuzë:PP/II.Nr.2182/19, të datës 17.11.2016, ndaj të pandehurit, V. B. , të vjedhjes së rëndë nga neni 327 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafin 1.1 tëKPK-së.

Meqë i pandehuri gjatë séancav të shqyrtimit gjyqësor nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila i ngarkohet, gjykata zbaton procedurën e provave. Me propozimin e prokurorit të shtetit dëgjohen I dëmtuari dhe I pandehuri:

I dëmtuari ka deklaruar se une jetoj në rr. „.....” me atë datë mu ka thy shtëpia, kanë hy për ballkani dhe janë kap për cevë. I njëjti deklaroi se une nuk dyshoj në askënd.

I pandehuri në mbrojtjen e tij ka deklaruar, se une kam qenë i dënuar për vjedhje të rëndë, për 2 vite e diqka burgim mku kam vujtur dënimin prej dt. 14.09.2016 deri në vitin 2019. I njëjti e mohoi të ketë kryer këtë vepër penale. Prokurori i shtetit ia prezantoi mendimin e ekspertit të daktiloskopisë të dt. 10.11.2016 ku ceket se gjurmët janë tërëhjekur në shtëpinë e të dëmtuarit Ibish me dt. 11.09.2016, pra dt. E kryerjes së veprës penale dhe këto gjurmë janë identike me shuplakën e dorës së majtë të V. B. .

Në shqyrtimin gjyqësor, në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit ka deklaruar: se pas administrimit të provave është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë gjendja faktike, se me dt. 11.09.2016 gjatë natës në rr. „.....” përmes forcës me qellim përvetësimi të kundërligjshëm të dobisë pasurore tjetrit ja merr pasurinë dhe atë të dëmtuarit I. M.. Provat me të cilat vërtetohet kjo gjendje faktike janë: Njoftimi i sektorit të hetimeve në Klinë, i dt. 11.11.2016, mendimi i ekspertit të daktiloskopisë i dt. 11.11.2016 në të cilën ceken gjurmët që janë marrë me dt. 11.09.2016 në shtëpinë e të dëmtuarit dhe te enjëjta gjurmë janë identike me shuplakën e dorës së majtë të akuzuarit V. B. i cili sot tha se kinse në shtëpinë e të dëmtuarit ka qenë pasi është kryer vepra penale, mirëpo kjo mbrojtje është në kundërshtim edhe me raportin e vendit të ngjarjes, ku pikërisht për këtë rast janë tërëhjekur gjurmët që kanë rezultuar të jenë të akuzuarit. Raporti i oficerit A. H. i dt. 11.09.2015, raporti i rreshterit M. M. i dt. 11.09.2016 e që në këto dy raporte ceket se janë tërëhjekur gjurmët të cilat kanë rezultuar të jenë të akuzuarit.. Raporti i vendit të ngjarjes, me të cilën vërtetohet mënyra e kryerjes së kësaj veprë penale, fotografit e vendit të ngjarjes. Andaj më këtë rast kemi një provë shkencore e cila për kah besueshmëria është pothuajse 100 për qind e sakt. Nga të lartëcekurat i propozoi gjykatës të marrë aktgjykim fajësues me rastin e marrjes së vendimit.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare deklaroi: se kërkon ndjekje penale për të akuzuarin.

I pandehuri në fjalën përfundimtare: kërkon nga gjykata që me rastim e marrjes së vendimit të më shqiptoi një dënim më të butë, pasi jam mbajtur i vetëm i familjes dhe jetoj nga

ndihma sociale. I premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjajshme penale. Une e

Gjykata pas administrimit të provave të prezantuara në aktakuzë, në shqyrtim gjyqësor i vlerësoj secilën me vëmendje një nga një dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, në bazë të nenit 361 të KPPRK-së dhe si rezultat i vlerësimit të tyre vërtetoj këtë gjendje faktike si në vijim:

Faktet e vërtetuara nga gjykata

Gjykata vërtetoi gjatë shqyrtimit gjyqësor, se i pandehuri V. B. , ditën me dt. 11.09.2016 merr sendet e luajtshme ku depërton me forcë dhe hyn në shtëpinë e të dëmtuarit I. M. , i cili sigurohet se shtëpia ishte pa mbikqyrje, i cili me mjet të përshtatshëm hap derën e ballkonit, ku dhe aty ka marr një „IPED”.

1). Vlerësimi i provave materiale

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi në bazë të raportit të: Njoftimi i sektorit të hetimeve në Klinikë, i dt. 11.11.2016, mendimi i ekspertit të daktiloskopisë i dt. 11.11.2016 në të cilën ceken gjurmët që janë marrë me dt. 11.09.2016 në shtëpinë; e të dëmtuarit, Raporti i oficerit A. H. i dt. 11.09.2015, raporti i rreshterit M. M. i dt. 11.09.2016 e që në këto dy raporte ceket se janë tërhequr gjurmët të cilat kanë rezultuar të jenë të akuzuarit.. Raporti i vendit të ngjarjes, me të cilën vërtetohet mënyra e kryerjes së kësaj veprë penale, fotografit e vendit të ngjarjes

A) Analiza dhe vlerësimi i provave personale, të cilave gjykata ju ka falur besimin

Gjykata ka analizuar deklaratën e, të dëmtuarit, i cili ka deklaruar se në shtëpinë time ka depertuar me forcë dikush, ku dhe më është marrë një „IPED”, mirëpo njëjti deklaroi se une nuk e di kush, ka qenë.

Kësaj deklarate gjykata pjesërisht ia falë besimin, pasi që e njëjta ishte në harmoni me provat materiale.

B) Analiza dhe vlerësimi i provës personale, të cilës gjykata nuk ju ka falur besimin:

Gjykata pasi vlerësoi mbrojtjen e të pandehurit, I cili erdh në përfundim se i njëjti nuk e pranon se e ka kryer veprën penale.Mirëpo gjykata deponimit të pandehurit nuk ia falë besimin, pasi deklarata e tij ishte më kundërshtim me provat materiale, pra i njëjti kishte për qëllim që ti ik përgjegjësisë penale.

c) Vlerësimi juridik i çështjes

Me të gjitha provat personale dhe materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të analizuar dhe të vlerësuara nga gjykata si: dëshmia e të dëmtuarit I. M., mbrojtja e të pandehurit e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, si provë materiale ekspertiza e daktiloskopisë, e që është provë shkencore, ku ceken gjurmët e shuplakave të dorës e që janë identike me shuplakën e dorës së majt të të akuzuarit, e të cilat prova gjykata i ka vlerësuar një nga një dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerrë përfundim se në tërësi është vërtetuar, se i pandehuri ka kryer veprën penale, vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nënparagrafin 1.1 të KPPRK-së, se i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij, si dhe në këto veprime është manifestuar dashja si element i fajësisë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë. Gjykata konsideron se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale të lartëcekur: kundërligjshmëria, dashja si formë e fajësisë, si dhe vetëdija, andaj përfundon se në veprimet e të të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet inkriminuese të kësaj veprë penale të cilat sajojnë figurën e veprës penale.

Duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 262 par.1 të KPPRK-së në të cilat përcaktohet: “gjykata nuk e shpallë të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie, apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.” Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjatë individualizimit të tij gjykata për të pandehurin Sami Gashi, ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese, sjelljen e tij në gjykatë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, faktin se i njëjti për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin.

Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar dashjen si formë e fajsisë, si dhe që i njëjti ka qenë i dënuar më parë për veprën penale vjedhje e rëndë me dënim burgu 2 vite e gjashtë muaj me aktgjykim me P. Nr. 160/15 i cili është bërë i plotëfuqishëm me dt. 30.05.2017.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-se.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata nuk gjeti, se i pandehuri ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor. Si rrethanë posaqerisht lehtësuese gjykata conform nenit 71 par. 1 pika 1.2 muar se i pandehuri pas vuajtjes së dënimit me burg prej 2 vite e gjysëm, është rehabilituar dhe risocializuar, i njëjti është i pa punë dhe mbajtës i vetëm i familjës.

Gjykatës ia ka prezantuar dëshminë se është shfrytëzues i skemës sociale, me nr. 49138 i lëshuar me dt. 19.01.2021 nga QPS në Klinë.

Rrethanë rënduese Gjykata gjeti shkallen e rrezikshmërisë që paraqet kjo veprë penale dhe dënueshmërinë e saj, si dhe veprën penale të kryer ku për këtë veprë penale parashihet dënim me gjobë dhe me burgim 3 vj. deri në 7 (shtatë) vjet.

Gjatë vlerësimit të provave të prezantuara në shqyrtim gjyqësor që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale të të akuzuarit, gjykata nuk ka gjetur asnjë bazë për përjashtimin apo zvogëlimin e përgjegjësisë së tij, andaj të njëjtini ka shpallë fajtor për veprën penale të lartëcekur.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të të pandehurit. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit si dhe në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike u mbështet në dispozitat ligjore të nenit 463 par.2 të KPPRK-së, duke e udhëzuar palën e dëmtuar që të njëjtën ta realizoj në kontest të rregullt civil.

Konform dispozitave ligjore të nenit 454 par.4 të KPPRK-së, i pandehuri lirohet nga shpenzimet procedurale.

Andaj nga arsyet e theksuara më lartë, dhe konform dispozitave ligjore të nenit 25 par.2, 26 par.2, 297 par .1, 364, dhe 370 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË KLINË

P.nr.58/19 të datës: 05.03.2021

Sekretarja Juridike

Shere Desku

G j y q t a r j a

Sabrije Rraci

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa

në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit,

Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË KLINË

P.nr.58/19, të datës: 05.03.2021

Gj y q t a r j a
Sabrije Rraci

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.